



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në seancën e 83-të të mbajtur më 15.03.2022 ka miratuar

### Vendim

Procedura për lëndën me nr. 08-3956 / 1 datë 09.10.2021, NDËRPRITET.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-3956/1 datë 09.10.2021.

Lënda me numër 08 –3956/1 të datës 09.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 08-3956 / 1 të datës 09.10.2021 është formuar me vetiniciativë .

Nga mbikëqyrja e evidencave të saj, KSHPK-ja ka konstatuar se personi ----- në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pas përfundimit të funksionit së anëtarit të Bordit të ----- nuk ka dorëzuar fletë anketuese në Komisionin Shtetëror për Parandalim e Korrupsionit.

KSHPK-ja përpiloi procesverbal për kundërvajtje dhe urdhërpagesën e konstatuar ia dorëzoi personit \_\_\_\_\_.

Duke qenë se personi \_\_\_\_\_ nuk ka vepruar me urdhërpagesë për kundërvajtje në afatin e paraparë me ligj, KSHPK ka paraqitur kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje komisionit për kundërvajtje në KSHPK.

Komisioni për kundërvajtje në KSHPK, me Vendim nr. 14-2777/5, datë 03.08.2022, e shpalli \_\_\_\_\_ përgjegjës për kundërvajtje nga neni 82 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit sipas nenit 109 të dënueshme me të njëjtin ligj dhe e dënoi me sanksion për kundërvajtje PARALAJMËRIM.

Duke pasur parasysh tē theksuarēn e mēsipērme, Komisioni Shtetēror pēr Parandalimin e Korrupsionit vendosi si nē dispozitēn e kētij vendimi.

Pērgatiti: Mr. Antonija A. Tasevska  
Miratoi: Biljana Ivanovska, Kryetare

**KOMISIONI SHTETĒOR  
PĒR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
NĒNKRYETAR,  
Katica Nikolovska**

